



Komuna e Skenderajt

NJOFTIM

Për Shqyrtimin Publik të projekt-“Harta Zonale e Komunës (HZK-së) së Skenderajt 2020-2028”

Komuna e Skenderajt (së bashku me kompaninë e angazhuar Vizion Projekt) dhe Programin për Zhvillim Gjithpërfshirës/ UN-Habitat-i kanë kënaqësinë të ftojnë qytetarët, shoqërinë civile, ekspertët, zhvilluesit, pronarët e tokave, komunitetet e ndryshme dhe të gjithë të interesuarit tjerë që të marrin pjesë në hapjen e Shqyrtimit Publik të projekt-“Harta Zonale e Komunës së Skenderajt 2020-2028”. Me atë rast do të prezantohet dhe diskutohet zonimi i të gjithë territorit komunal së bashku me shfrytëzimin e tokës, kushtet e përgjithshme, kushtet ndërtimore; si dhe infrastruktura, vendbanimet joformale, planet rregulluese të hollësishme, etj.

Takimi hapës mbahet më 14 shkurt 2020 (e premte) ora 10:30
Salla e Kuvendit – Komuna e Skenderajt

I gjithë materiali (projekt dokumenti i HZK-së së bashku me hartat dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)) do të jetë në dispozicion të të interesuarve për **30 ditë rresht, nga 14 shkurt deri më 16 mars**, në format e mëposhtme:

- Materialin e gjeni në vegëzën elektronike: <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/> ndërsa komentet mund të adresohen në e-mailin: lorije.qerimi@rks-gov.net
- Materialin në kopje fizike dhe sqarimet nga personeli i gjeni në **Ndërtesën e Komunës së Skenderajt, kati 3 tek Drejtoria e Urbanizmit** ndërsa komentet mund të shkruhen në librin që gjendet po aty;
- Peticionet në lidhje me projekt-HZK-në duhet të dorëzohen në Arkivin e Komunës së Skenderajt në katin përldhesë;
- Materiali do të prezantohet dhe komentet gjithashtu mund të bëhen nëpër takimet në zonat rurale që do të organizohen si më poshtë:
 - Për vendbanimet Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Polac, Lubovec dhe Mikushnicë takimi do të mbahet në Prekaz të Epërm tek shkolla, me datë **18.02.2020 në ora 11.00;**
 - Për vendbanimet Klinë e Epërme, Klinë e Mesme, Klinë e Poshtme, Kuqicë, Tërnavc dhe Kotorr takimi do të mbahet në Klinë të Epërm tek shkolla, me datë **18.02.2020 në ora 13.30;**
 - Për vendbanimet LLaushë dhe Tushilë takimi do të mbahet në LLaushë tek shkolla, me datë **20.02.2020 në ora 11.10;**
 - Për vendbanimet Turiqec, Burojë, Kopiliq i Poshtëm, Kopiliq i Epërm, Vajnik, Rakinicë dhe Aqarevë takimi do të mbahet në Turiqec tek shkolla, me datë **20.02.2020 në ora 13.30;**
 - Për vendbanimet Likoc, Rezallë, Marinë, Murgë, Kryshevc, Ticë dhe Makërmal takimi do të mbahet në Likoc tek shkolla, me datë **25.02.2020 në ora 11.10;**
 - Për vendbanimet Qirez, Baks, Krasmirov, Kozhicë, Krasaliq, Prelloc, Dashevc dhe Kralicë takimi do të mbahet tek shkolla me datë **25.02.2020 në ora 13.30;**
 - Për vendbanimet Runik, Çubrel, Vitak, Banjë, Pemishtë, Kostërc, Radishevë, Izbicë, Syriganë dhe Kllodernicë takimi mbahet në Runik tek shkolla me datë **27.02.2020 në ora 11.10;**

Harta Zonale është një dokument me karakter zonifikues dhe rregullues dhe pas aprovimit do të shërbejë si bazë për zhvillim fizik të territorit komunal. Procesin e planifikimit në tërësi e përkrahë edhe **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)** me të dhëna dhe konsulencë.

Mirëpresim kontributin e qytetarëve në finalizimin e Hartës Zonale të Komunës së Skenderajt!

Ky aktivitet mbështetet nga:



INCLUSIVE
DEVELOPMENT
PROGRAMME

Program i implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

PAX

CBM
Community Building Mission

dhe i financuar nga
SWEDISH
DEVELOPMENT
COOPERATION

